

Date: 13.06.2018

**S T A T U T**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"TRADITION & ADVENTURE"**

**KAPITULLI I**

**Emërtimi - Selia - Jetëgjatësia**

**Neni 1 - Themelimi**

Është krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "**TRADITION & ADVENTURE**" SH.P.K. mbi bazën e aktit të themelimit.

**Neni 2 - Selia**

Shoqëria e ka selinë ligjore në Tirane me adresë : Rruga Rruga Iliria Nr. 104  
Laprake Tirane

**Neni 3 - Selia sekondare**

Asambleja e jashtëzakonshme mund të formojë seli sekondare ose t'i suprimojë ato, ndërsa organi administrativ mund të krijojë e suprimojë filiale, degë, agjensi dhe zyra përfaqsimi ne territorin Shqiptar dhe jashte saj.

**Neni 4 - Jetëgjatësia**

Jetëgjatësia e shoqërisë është vendosur nga data e krijimit pa afat.

**KAPITULLI II**

**Objekti**

**Neni 5-Objekti e qëllimet shoqërore**

Shoqëria ka për objekt:

- Aktivitet ne fushen e Turizmit, Hoteleri, Bar e Restorant, hapje agjensie Turistike, per shitblerje biletash udhetimi udhetares, per linjat e udhetimit brenda dhe jashte vendit.
- Transport ajror, detar e tokësor te udhetareve dhe te mallrave te te gjithe llojeve; transporti per nevojat e shoqerise dhe te trete.
- Sherbim transporti turistik te udhetareve brenda dhe jashte vendit.

- Dhenie dhe marrje automjetesh me qera.
- Si dhe sipermarrje te ndryshme, ne perputhje me kerkesat qe burojne nga ligjet ne fuqi.

Shoqëria me qëllim të arritjes së objektivave shoqërore mund të marrë përsipër si direkt ashtu edhe indirekt, pjesmarrje në fitime e pjesmarrje në shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja që kanë objekt analog ose të lidhur me të tyren.

### **KAPITULLI III**

#### **Kapitali shoqëror-Kuotat**

##### **Neni 6-Kapitali shoqëror**

Kapitali shoqëror është 100.000.00 ( njeqindmije) lekë, i ndarë në 1 kuote

- ALKIDA DEDE ..... 100.000,00 leke ose 100 % te kapitalit, 1 kuote

##### **Neni 7-Kuotat**

Çdo kuotë të jep të drejtën e një vote.

##### **Neni 8-E drejta e pronesisë**

Posedimi qoftë edhe i një kuote përbën në vetvehte pranimin e aktit të themelimit dhe të këtij statuti.

##### **Neni 9-Trasferimi i kuotave**

Kuotat e shoqërisë janë lirisht të trasferueshme midis ortakëve, duke respektuar të drejtën e parablerjes që çdo ortak mund të ushtrojë në përputhje per përqindjen e kuotës që ai posedon.

Kuotat e shoqërisë mund tu trasferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm kur Asambleja vendos me shumicën e ortakëve që përfaqsojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar.

Çdo ortak që dëshëron t'u trasferojë të tretëve kuotën e tij ose pjesë të saj, duhet më parë t'ia ofrojë atë nëpërmjet një letër rekomandeje ortakëve të tjerë, të cilëve u takon e drejta e parablerjes ndaj së tërës, në përputhje me përqindjen e kuotave të tyre në kapitalin themeltar.

Oferta e blerjes duhet të përbajë sasinë e kuotave që do të transferohen,

çmimin përkatës dhe mënyrën e pagesës.

Kur jo të gjitha kuotat e ofruara blihen nga ortakët brenda tre muajve nga dita e ofertës, shitësi ka të drejtë t'i shesë të tretëve kuotat e pashitura, me kusht që çmimi i shitjes të mos jetë më i ulët se ai i kërkuar ortakëve.

## **KAPITULLI IV**

### **Asambleja**

#### **Neni 10-Fuqitë e Asamblesë**

Asambleja e thirur dhe e përbërë rregullisht, përfaqson vendimet e ortakut te vitem, të marra në përputhje me ligjin dhe këtë statut.

#### **Neni 11-Modalitetet e thirrjes**

Thirjet e Asamblesë bëhen nën kujdesin e administratorit qe eshte dhe ortaku i vitem i shoqerisë

Asambleja e thirur me formalitetet e ligjit mund të mbahet veç selisë së shoqërisë, edhe jashtë saj, në atë vend që do të tregohet në lajmërimin e thirjes. Asambleja e zakonshme duhet të thirret së paku një herë në vit, brenda 4 muajve nga mbyllja e vitit ushtrimor.

Sa herë që nevoja të veçanta e kërkojnë, Asambleja mund të vendosë një afat më të madh, por në asnjë rast mbi gjashtë muaj nga mbyllja e vitit ushtrimor.

Asambleja e jashtëzakonshme thirret për vendime të kompetencës së saj. Thirja e Asamblesë duhet gjithashtu të behet pa vonesë, kur është bërë kërkesë nga ortakët në bazë të ligjit.

#### **Neni 12-Pjesmarrja dhe Delegimi**

E drejta e pjesmarrjes në Asamble rregullohet nga dispozitat që përmban neni 85 i Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 «Për tregtaret dhe shoqëritë Tregtare» dhe nga dispozitat e tjera të ligjit.

#### **Neni 13-Drejtimi i Asamblesë**

Presidenca e asamblesë i përket administratorit që ka ndërmarrë iniciativën për thirrjen e saj.

Asambleja emëron një sekretar, edhe jo ortak.

### **Neni 14-Vlefshmëria e Asamblesë**

Asamblea e zakonshme vendos me votën e favorshme të ortakut te vetem që përfaqeson 100 perqind te kapitalit themeltar.

### **Neni 15-Proçesverbalı**

Vendimet e Asamblesë duhet të rezultojnë nga proçesverbalı i firmosur nga Administratori dhe nga Sekretari.

Proçesverbalı redaktohet nga noteri në rastet e parashikuara në ligj.

### **Neni 16-Administrimi**

Në përputhje me nenin 95 te Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", shoqëria administrohet nga Administratori i vetem, me te drejte firme e perfaqesimi te shoqerise. Per shitjen e pasurive qe perbejne kapitalin shoqeror apo hyjne ne aktivin e shoqerise, duhet firma e administratorit te vetem.

Administratori i shoqerise "**TRADITION & ADVENTURE**" **Sh.p.k.** eshte caktuar Znj. Alkida Dede, e cila eshte dhe ortaku i vetem i shoqerise me afat 5 vjet nga data e hyrjes ne fuqi të statutit.

### **Neni 17-Delegimi i fuqive(kompetencave)**

Administratori mund t'i delegojë atributet e tij, duke përcaktuar caqet e delegimit:

- Një Drejtori të Përgjithshëm ose komercial.

### **Neni 18-Fuqitë e Organit Administrativ**

Administratorit i takojne keto kompetenca :

- Fuqitë (të drejtat) për administrimin e aktivitetit të shoqërisë dhe për përbushjen më së miri të objektit shoqëror;
- Mbikqyrjen e kontrollin e aktivitetit e të pasurisë së shoqërisë, me të drejtën e kryerjes së të gjitha operacioneve dhe akteve që çmohen të nevojshme për përbushjen e objektit shoqëror brenda caqeve të përcaktuara nga Asambleja, duke përjashtuar vetëm ato që ligji e statuti ja rezervojnë asamblesë së zakonshme apo të jashtëzakonshme;
- Përfaqëson shoqërinë para të tretëve, duke respektuar objektin shoqëror, autoriteteteve gjyqsore, administrative e notoriale;

- Fuqitë për organizimin e shoqërisë me të drejtën e krijimit e rregullimit të zyrave të ndryshme (përfshirë Drejtorë, teknikët e nëpunësit), duke përcaktuar funksionet e të drejtat, kriuar e suprimuar organe konsultative.

### **Neni 19-Përfaqsimi i shoqërisë**

Përfaqsimi i shoqërisë i përket në vijë të përgjithshme e pa kufizime, Administratorit te vetem.

Përfaqsimi i shoqërisë i përket gjithashtu:

- përfaqsuesve të posaçëm, që mund të emërohen për akte apo kategori aktesh të veçanta, nga të gjithë subjektet e treguar në këtë nen, secili brenda të drejtave të tij.

### **Neni 20 - Shpërblimi i administratorit.**

Administratorit i përket kompесimi për shpenzimet e kryera për arsyen e zyrës si dhe një shpërblim, që mund t'ju përcaktohet nga asambleja e zakonshme me vendim të vlefshëm deri në ndryshimin e tij.

## **KAPITULLI V**

### **Kontrolli i shoqërisë**

### **Neni 21-Ekspertët kontabël të regjistruar**

Asambleja e zakonshme emëron në rastet e parashikuara nga nen 135 i Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" një apo disa ekspertë kontabël të regjistruar. Shpërblimi i tyre përcaktohet nga asambleja në aktin e emërimit.

## **KAPITULLI VI**

### **Bilanci**

### **Neni 22 - Viti ushtrimor**

Viti ushtrimor mbylljet më 31 dhjetor të çdo viti.

### **Neni 23 - Bilanci**

Në fund të çdo viti organi administrativ merr masa në përputhje me urdhërimet e ligjit, për kryerjen e bilancit të shoqërisë.

## **Neni 24 - Fitimet**

Fitimi neto i bilancit ndahet si vijon:

- a) 5 % (pesë përqind) destinohet për rezervën ligjore deri sa ajo mos të ketë arritur një të dhjetën e kapitalit shoqëror, si dhe kur rezerva ka zbritur nën këtë shumë, deri në riplotësimin e saj;
- b) pjesë e mbetur do të ndahet sipas vendimeve të asamblesë.

## **KAPITULLI VII**

### **Dispozita të përgjithshme**

#### **Neni 25 - Zgjidhja e likuidimi**

Aktiviteti pushon dhe shoqëria zgjidhet, kur:

- përfundon afati i kohëzgjatjes së vendosur;
- pamundësia për të mbuluar humbjet e shoqërisë nga ana e të gjithë ortakëve, në përputhje me kuotat shoqërore që ata posedojnë;
- në çdo rast me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme që do të emërojë një ose më shumë likuidatorë duke fiksuar të drejtat e shpërblimin.

#### **Neni 26 - Klauzola e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë rreth vlefshmërisë, interpretimit dhe ekzekutimit të kësaj kontrate, do ti besohet vendimit të Gjykatës së vendit ku shoqërija ushtron aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 27- Referim**

Për gjithçka sa nuk është parashikuar zbatohen normat e Kodit Civil dhe ligjet e tjera të fushës përkatëse.

**O R T A K U I VETEM**

**ADMINISTRATORI**

**Alkida Dede**

